

Fotomontazh që tregon planetet në rrethin e tyre të distancës nga Dielli (për ti treguar të gjitha, nuk janë respektuar madhësitë dhe distancat).

Disa planetet kanë unaza. Unazat e Saturnit njihen prej kohësh dhe mund të vrojtohen me një teleskop amatorësh.



## Planetet

Planetet



**Disa mund t'i shohim me sy të lirë, si pika të vogla të ndritshme në qiell.**

**Me teleskop mund të shquajmë formën e rru mbullit dhe ngjyrat e tyre.**



## Planetet

Rreth Diellit sillen 8 planetet. Ato janë, sipas rradhës: Merkuri, Afërdita, Toka, Marsi, Jupitri, Saturni, Urani dhe Neptuni. Disa janë shkëmbore, të tjerat janë të gazta.

Disa kanë hëna, si Toka (që ka vetëm një).


Në Galaksit janë zbuluar me mijëra planetet që sillen secili rreth diellit të vet.

Një "shi" yjesh që "bien" në Kil. Rrezet e ndritshme dukën sikur vijnë nga e njëjta pikë. (foto nga Yuri Beletsky)



## Yjet që "bien"

Yjet që "bien"



**Na dukën si flashe drite, që përshkojnë qiellin sa hap e mbyll sytë.**

**Shpesh vijnë në grupe.**

## Yjet që bien

Nuk janë yje, por grimca të vogla që vijnë nga hapësira. Këto grimca digjen kur hyjnë në atmosferë dhe lënë një gjurmë drite.

Kur Toka kalon në trajektoren e ndonjë komete, që ka shpërndarë re pluhurash pas vetes, ne shohim një « shi yjesh që bien ».

« Shirat » më të forta ndodhin në Gusht dhe Tetor.



## Toka

Dihet prej kohësh që Toka nuk është e sheshtë, siç mund ta besonim duke parë motull nesh. Ajo është e rrumbullakët si një top.

Toka sillt motull Diellit, por meqë jetojmë në Tokë, na duket sikur Dielli sillt rreth saj.

Në sajë të tërheqjes që Toka ushtron mbi ne, ne ecim kudo mbi sipërfaqen e saj pa fluturuar në hapësirë.

**Çështje një gjë e rrumbullakët, E mbuluar me ujë, male, pyje, dhe me shkretëtira,**

**Dhe ku jetojnë me miliona lloje qëniesh të gjalla?**



Një pejsazh në Tokë



## Toka



Foto e Tokës, e marrë nga një satelit i NASA-s. Shihet Amerika e Veriut dhe e Jugut.

Universi në xhepin tim



## Të zbulojmë Diellin, Tokën dhe Qiellin



Grażyna Stasińska  
Observatori i Parisit

Një foto e Diellit, e marrë me fitorë special (SOHO). Protuberancat shihen qartë.



## Le Soleil

Parja e Diellit në qiell



**Është e verdhë**  
**Dhe ndriçon zbehtë natën.**  
**Nganjëherë na shfaqet e**  
**rrumbullakët,**  
**Hera-herës i ngjan një drapëri.**



## Hëna

Hëna silltet rreth Tokës dhe ndriçohet nga Dielli.  
Njerëzit kanë ecur mbi Hënë në 1969, 1971 dhe 1972. Meqë Hëna nuk ka atmosferë, ata u desh të mbanin veshje speciale për të marrë frymë. Meqë pesha mbi Hënë është 6 herë më e lehtë se pesha mbi Tokë, këto veshje që peshonin mbi 70 kile i ndjenin krejt të lehta.

**Si e imagjinoj unë qiellin**

Përkthimi: Milnoza Hafzi  
TUMIP Creative Commons



Për të ditur më shumë mbi këtë koleksion dhe gëshjtët e paraqitura në këtë minilibër, mund të kontaktoni faqen <http://www.tuinip.org>



**Faqja e fundit e librit jep dy paraqitje të ndryshme të qiellit, të imagjinuara nga artistët të hemisferës jugore (sipër) dhe të hemisferës veriore (poshtë).**  
**Po ti, si e imagjinoj qiellin?**  
**Vizatoje në faqen anash.**


Grażyna Strażnińska, e Observatorit të Parisit, e shkroi këtë minilibër në vitin 2022 dhe ia ka dedikuar nipit të saj 5 vjeç, Côme. Vizatimet i ka bërë Aksen, 8 vjeç.

**Universi në xhepin tim n° 34**


**I shohim si pika xixëlluese në qiell, sapo bie nata.**  
**Aty ku ka shumë, dritat e tyre përzihen në një fashë të shtrirë e të gjatë me emrin Rruga e Qumështit.**




Natë me yje



## Yjet



Një foto e qendrës së Krugës së Qumështit, e marrë në Brazil nga B. Tafreshi. Djathtas shihet Xjësia e Kryqit të Jugut.




## Yjet

Yjet janë topa zjarri, si Dielli ynë. Por ndodhen shumë shumë më larg. Ata na dukën si pika xixëlluese.  
Yjet nuk kanë të njëjtën ngjyrë: të bardhat dhe blutë janë më të nxehta, të verdhat kanë temperaturën që ka Dielli, të kuqet janë më të ftohta.  
Me sy të lirë mund të shihen disa mijëra. Në Rrugën e Qumështit ka me miliardë yje.


Dielli është një top zjarri.  
Në sipërfaqen e tij ndodhin shpërtithe që mund të dëmtojnë telekomunikimin në Tokë.  
Pa Diellin nuk do të kishte jetë në Tokë, sepse ai i jep energji birmëve për t'u nrtur e ato na furnizojnë me ushqim dhe me oksigjen për të marrë frymë. Drita e Diellit bën & minuta për të mbërritur në Tokë.

## Dielli


**Ç'është një gjë e rrumbullakët dhe e verdhë,**  
**Që lind e perëndon?**  
**Që na ndriçon e na ngroh përditë?**  
**E që natën zhduket?**



Një parje e Hënës



## Hëna



Drapëri i Hënës « në këmbë »  
Foto nga Gary Hart  
Drapëri i Hënës « ishtinë »  
Foto nga Tavi Greiner  
Orientimi i drapërit të Hënës varret nga ora, stina dhe vendi mbi Tokë nga e shohim.